



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGETARE

URDHER

Nr. 896 Date 4.12 2007

PER DEPOZITIMIN E STATUTIT TE  
SH.A. " UJESJELLES" MAT

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1. Depozitimin e statutit te ndryshuar te shoqërisë Sh.A. " Ujësjiellës " Mat.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.



MINISTRI

GENCRULI





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UJESJELLES MAT SH.A.

Drejtorise Tregtare  
*[Signature]*

Adresa: Lgji "Partizani" Rr "Ibrahim Temo" Nr 6. e-mail : ujesjelles mat.sha@gmail.com Tel :+355 21722542

Nr. 424 Prot

Burrel, me 26 / 04 2018

VENDIM

NR 11 DATË 26.04 2018

PER

MIRATIMIN E RAPORTIT E AUDITUESIT LIGJOR PER ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SHOQERISE  
"UJESJELLES MAT SHA"

Asambleja e shoqerise "UJESJELLES MAT SHA", pasi shqyrtoi raportin e paraqitur nga Audituesi Ligjor z .Bujar Rami, Per Zmadhimin e Kapitalit të Shoqërise "Ujesjelles Mat Sha", në zbatim të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 , " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ( indryshuar ), neni 87 pika 1, neni 145 pika 1, neni 168 pika 1, neni 169 pika 1, dheneni 178 pikat 1 dhe 2,

VENDOSI:

- 1.Miratimin e raportit të Audituesit Ligjor z.Bujar RAMI Për Zmadhimin e Kapitalit Aksionar te Shoqërisë "UJESJELLES MAT SHA" ,nga 192,415,000 lekë , në 729,777,000 leke
- 2.Nr i aksionave do të pakësohet nga 192,415 në 1 aksion.
- 3.Ngarkohet Shoqeria "Ujesjelles Mat Sh.a" për depozitimimin e këtij vendimi në QKB.
- 4.Ky Vendimhyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I ASAMBLESE

NEZIR RIZVANI



Mr 542/1 prot  
Dt. 05.12.2017.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UJESJELLES MAT SH.A  
ASAMBLEA

Adresa : Lgj "Partizani", Rr "Ibrahim Temo", Ndertesa Nr 6, Tel : +355 217 22542

VENDIM

NR 7 DATË 4.12 2017

PER

MIRATIMIN E RAPORTIT TE EKSPERTEVE VLERESUES DHE CAKTIMIN E  
EKSPERTIT LIGJOR PER ZMADHIMIN TE KAPITALIT TE SHOQERISE  
"UJESJELLES MAT SHA"

Ne mbeshtetje të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 , " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(I ndryshuar) ,neni 87, pika 1, neni 145,pika 1, Neni 168, pikal ,Neni 169, pika 1 , dhe neni 178 pikat 1 dhe 2, Asamblea e Shoqerise "Ujesjelles Mat Sh.a"pasi mori ne shqyrtim Raportin e Eksperteve Vleresues per "Vleresimin e Ujesjellesave te Njesive Administrative qe do i kalojne ne pronesi e administrim kesaj shoqerie":

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit te Eksperteve Vleresues Vahide Gruda e Sami Gjeta "Per Vleresimin e Ujesjellesave te Njesive Administrative: Ulez, Baz, Komsi, Lis, Macukull, Derjan qe do i kalojne ne administrim Shoqerise "Ujesjelles Mat Sha".
2. Caktimin e Z. Bujar Rami me profesion Auditues Ligjor, te pergatise Raportin dhe vleren e Zmadhimit te Kapitalit Aksionar te Shoqerise "Ujesjelles Mat Sha" bazuar ne raportin e Eksperteve Vleresues.
3. Ngarkohet Shoqeria "Ujesjelles Mat Sh.a" per zbatimin e ketij vendimi.

Ky Vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I ASAMBLESE

NEZIR RIZVANI



01.12.2017

## Raport

### Mbi vlerësimin e Ujësellsava të Njësive Administrative Mat.

Drejtuar: Asamblesë Përgjithshme

të Ujësjellës sha

Mat.

Në bazë të Vendimit Nr 4, datë 04.10.2014 "Për caktimin Ekspertëve Vlerësues të Ujësjellsave të Njësive Administrative" dhe Urdhërit Nr 5... datë 4.10.2017 të Ujësjellës Mat Sha (Asambleja e Përgjithshme) , "Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ujësjellsave të Njësive Administrative Mat, komisioni i përberë nga ekspertët vlerësues Zj.Vahide Gruda me nr liç Vp 0237/1 dhe Z.Sami Gjeta me nr liç Vp 1300.

Vlerësimi është bërë sipas parimeve të përgjithshme të Vlerësimit që aplikohen edhe në vendet europiane , në përputhje me Manualin e Standarteve Europiane të Vlerësimit.

Ujësjellësat deri në zbatimin e Reformës Teritoriale (korrik 2015), kanë qenë në pronësi të Ish Komunave, tani Njësitë Administrative. Me bashkimin e tyre në Bashkinë Mat, si cdo aset edhe këto Ujësjellesa, pas vlerësimit të tyre do të hiqen nga AQT-të e Bashkisë Mat dhe do të kalojnë në administrim Ujësjellës Sha Mat.

Ekspertët vlerësues për të përcaktuar Vlerën e Ujësjellsave kanë marrë parasysh që Vlerësimi i Pronës do kryhet për Qellim të Raportimit Financiar, gjendja fizike e pronës, vendndodhja e saj, kushtet në të cilat ndodhet. etj. Vlera e tregut të lirëtë kësaj prone është llogaritur në bazë të dokumentave bazë (situacioni përfundimtar i punimeve, akt marrje në dorëzim dhe akt-kolaudimi i iobjektit) të marra nga dosjet e zbatimit të projektit i krahasuar me të dhënat kontabile të pasqyruara në bilanc.

Te dhënat e Ujësjellsave për vlerën e tyre fillestare, dmth kostoja e marrjes në kontabilitet dhe amortizimin e tyre, janë marrë nga Zyra e financës në Bashkinë Mat.

Vlerësimi është bërë mbështetur në Standartet Ndërkombetare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standartet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) të hartuara nga Komiteti Nderkombetar i Standarteve të Kontabilitetit (KNSK) dhe Bordi Nderkombetar i Standarteve të Kontabilitetit (BNSK që nga Prilli 2001), në interesin publik, ofrojnë një set të vetemkonsekuent dhe uniform standartesh. Shumica e këtyre standarteve të raportimit financiar nëpërmjet Rregullores së Komisionit (EC) Nr 1725/2003 të datës 20 Shtatorë 2003, janë adoptuar disa nga Standartet Ndërkombetare të Vlerësimit në përputhje me "Regulation



(EC) 1606/2002".Ndërsa në Shqipëri ato janë pranuar dhe miratuar në Ligjin 9228,date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" .

Standartet Ndërkombetare të Vlerësimit aktualisht adoptojnë dy modele për njohjen e aseteve prona në bilanc:

Metodën e Kostos; Pas njohjes si aset ,“Një AQT (Aktiv i Qendrueshëm i Trupezuar) i pronës,makinerve dhe pajisjeve do të mbartet me koston e tij deri në momentin e marrjes në kontabilitet,minus amortizimin e akumuluar, dhe cdo humbje apo demtim” (SNK 16 pjesa 28) dhe;

Metodën e Vlerës së Drejtë ,duke u bazuar në cmimin me të cilën prona mund të shkëmbehet ose të shlyhet detyrimet midis palëve të vullnetshme ,të mireinformuara në një transaksion normal (SNK 40).

Meqenëse kemi të bëjmë me Ujësjetësën të cilët përbëhen kryesisht nga makineri e pajisje dhe ndërtesë, **vlerësimi është bërë me Metodën e Kostos**.Kjo kosto është çmimi cash ekuivalent i kësaj prone në datën e vlerësimit dhe përfshin çmimin e blerjes,taksat doganore,shpenzimet e ndërtimit dhe montimit,si dhe cdo shpenzim tjetër të përfshirë në kosto.

Kësaj vlere i është zbritur amortizimi i akumuluar sipas Ligjit Nr 8438,datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.Gjithashtu kësaj vlere i janë zbritur edhe dëmtimet apo humbjet e pësuar gjatë shfrytëzimit,duke e vlerësuar për vlerën neto në momentin e përcaktimit të vlerës.

Ekspertët vlerësues kanë patur rezervime në lidhje me :

- Nuk kanë inspektuar gjendjen gjeofizike të tokës , për pasojë nuk kemi në gjendje të raportojmë mbi mungesën e rrezikshmerisë dhe të papërshtatshmerisë së kësaj prone në ndërtim.Te gjitha inspektimet janë bërë vetëm nga niveli sipërfaqësor .
- Gjithashtu është supozuar se këto prona janë të lira nga çdo barrë , kufizim pronësie , apo pretendim të paleve të tjera.
- Vlerësimi i Ujësjetësave është bërë në bazë të vlerave të marra sipas SNK 16 pjesa 32.Ai nuk parashikon ndryshimet në përgjithësi të tregut në të ardhmen , si dhe ndryshimet që mund të pesojë në parametra të veçante të pronës apo të zonës ku ndodhet prona objekt i këtij vlerësimi.

Po kështu kanë supozuar për qëllim të këtij vlerësimi , se:

- Nuk ekzistojnë ndotje ( ose kostoja e punës për pastrimet do të jetë papërfillshme në vlerësim).



- Nuk supozohet asnjë përgjegjësi për ekzistencën e ndonjë ndotje, as për ndonjë ekspertizë apo kërkim shkencor të kërkuar për ta zbuluar atë.

Ndërsa lidhur me pronësinë kanë përcaktuar:

.- Për efekt të këtyre vlerësimeve është supozuar se Prona është e lirë nga çdo barrë, detyrim ligjor dhe pronësia është e pastër.

- Nuk janë bërë rezultate kërkimesh në hipotekë dhe në organe të tjera shtetërore, por mund të themi se nuk disponojmë të dhëna për pasaktësi të saj. Kushtet për përdorimin e tanishëm dhe të ardhshëm të saj, janë të ligjshme.

- Kanë supozuar se nuk ka asnjë problem me përdoruesit e pronës dhe se nuk ka asnjë problem ligjor në lidhje me këtë çështje. Megjithatë është menduar se këto çështje duhet të kalojnë për shqyrtim Këshilltarit Tuaj ligjor.

- Mosinspektimi i vendeve të veçanta nuk sjell asnjë ndryshim në vlerësim. Nuk do të kenë asnjë detyrim të verifikojnë këto supozime duke u bazuar vetëm në informacionin e ofruar prej klientit.

**Sa më sipër ekspertët vlerësues kanë përgatitur raportet e vlerësimit për çdo ujesjellës në vlerë, si më poshtë:**

#### **1-Njësia Administrative Ulëz.**

a- Ujesjellësi Ulëz, vlerësuar në vlerë **33.379.883 leke**. Bashkalidhur raporti i vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot, prej **42 fletësh**.

b- Kanal Ujërave të Zeza Ulëz, vlerësuar në vlerë **24.762.737 lekë**. Bashkalidhur raporti i vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot, prej **27 fletësh**.

#### **2-Njësia Administrative Macukull.**

a- Ujesjellësi fshati Macukull, vlerësuar në vlerë **63.502.539 lekë**. Bashkalidhur raporti i vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot, prej **24 fletësh**.

b- Ujesjellësi lagja Cuka-Gjucaj-Valxhi, vlerësuar në vlerë **19.572.438 lekë**. Bashkalidhur raporti i vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot, prej **16 fletësh**.

c- Ujesjellësi fshati Vig, vlerësuar në vlerë **32.655.100 lekë**. Bashkalidhur raporti i vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot, prej **17 fletësh**.



### **3-Njësia Administrative Derjan.**

a- Ujësjetllësi fshati Lami Madh, vlerësuar në vlerë **4.517.084 lekë** .Bashkalidhur raporti I vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot , prej **27 fletësh**.

b- Ujësjetllësi fshati Mësuç, vlerësuar në vlerë **120.960 lekë** .Bashkalidhur raporti I vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot , prej **12 fletësh**.

### **4-Njësia Administrative Komsj.**

a- Ujësjetllësi fshati Gërman, vlerësuar në vlerë **35.0613.31 lekë** .Bashkalidhur raporti I vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot , prej **20 fletësh**.

b- Ujësjetllësi fshati Frankth, vlerësuar në vlerë **55.821.784 lekë** .Bashkalidhur raporti I vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot , prej **26 fletësh**. Te dhënat për vlerësim janë mërrë nga Fondi Shqiptarë i Zhvillimit.

c- Ujësjetllësi fshati Muzhakë, vlerësuar në vlerë **33.506.518 lekë** .Bashkalidhur raporti i vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot , prej **18 fletësh**.

### **5-Njësia Administrative Lis.**

a- Ujësjetllësi fshati Shoshaj, vlerësuar në vlerë **32.762.095 lekë** .Bashkalidhur raporti I vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot , prej **18 fletësh**.

b- Ujësjetllësi fshati Mallunxë, vlerësuar në vlerë **47.040.798.lekë** .Bashkalidhur raporti I vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot , prej **20 fletësh**.

### **6-Njësia Administrative Baz.**

a- Ujësjetllësi fshati Karicë, vlerësuar në vlerë **11.697.802 lekë** .Bashkalidhur raporti I vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot , prej **22 fletësh**.

b- Ujësjetllësi fshati Baz, vlerësuar në vlerë **142.961.216 lekë** .Bashkalidhur raporti I vlerësimit së bashku me projektet dhe fotot , prej **19 fletësh**.





Në total numri i Ujësjellsave të Vlerësuar është 14 (katërbëdhjetë), në vlerë 537.362.285 (pesëqind e tridhjetë e shtatë milion e treqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.

Raporti i vlerësimit përpilohet në 4 kopje të njëjta dhe firmoset rregullisht nga Komisioni i Vlerësimit.

Ekspert Vlerësues Pasurive Paluajtshme

Vahide Gruda



Ekspert Vlerësues Pasurive Paluajtshme

Sami Gjeta



Burrel, më 04.12.2017



**RAPORT**

**IAUDITUESIT TË PAVARUR**

**PËRZMADHIMIN E KAPITALIT AKSIONAR TË RËGJISTRUAR TË SHOQËRISË « UJESJELLES MAT »  
sh.a**

**Drejtuar: KRYETARIT TË ASAMBLESË SË « UJESJELLES MAT » sh.a**

**Z. Nezir Rizvani**

**Burrel**

**I nderuar z Kryetar**

Me cilësinë e Audituesit Ligjor , i emëruar nga Ju sipas Vendimit Nr.7 datë 04/12/2017 të Asamblesë të Shoqërisë « UJESJELLES MAT » sh.a, kemi kryer proceduren për zmadhimin e kapitalit aksionar të regjistruar të kësaj shoqërie, si më poshtë vijon :

**Baza ligjore për realizimin e këtij misioni është:**

- Ligji Nr. 7850, datë 29/07/1994 “Kodi Civil i Republikë së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9228, datë 29/04/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finaciare”.
- Ligji Nr. 10091, datë 05/03/2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”
- Ligji Nr. 9723, datë 05/05/2007 “Për Qendrën Kombetare të Regjistrimit”.
- VKM.Nr,63,datë 27.01.2016 « Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm,grumbullimin,largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
- Vendimit Nr. 7 datë 14/12/2017 të Asamblesë së « UJESJELLES MAT » sh.a Burrel.

Ky mision është kryer në pajtim me SNA-të (Standartet Ndërkombëtare të Auditimit) të publikuara nga IAASB (Bordi Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Sigurisë) të IFAC (Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve).

Pergjegjësia e drejtimit të shoqërisë « UJESJELLES MAT » sh.a është: Përgatitja dhe paraqitja e drejtë dhe reale e deklarimeve financiare, juridike dhe informacioneve të tjera të domosdoshme për dhënien e sigurisë së procesit të zmadhimit të kapitalit aksionar të shoqërisë.



- Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi Zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë « UJESJELLES MAT » sh.a nëpërmjet vlerës së rezultuara sipas Raportit “Mbi vlerësimin e Ujësellsave të Njësive Administrative Mat” të datës 18.12.2017 të Ekspertëve Vlerësues të Pasurive të Paluajtshme zj.Vahide Gruda dhe z Sami Gjeta,raport I cili është bërë në bazë të Vendimit Nr 4, datë 04.10.2014 “Per caktimin Ekspertëve Vlerësues të Ujësellsave të Njësive Administrative” dhe Urdhërit përkatës të Ujësells Mat Sha (Asambleja e Përgjithshme).

Siç theksohet në këtë raport të Ekspertëve Vlerësues të Pasurive të Paluajtshme,vlerësimi është bërë sipas parimeve te përgjithëshme të Vlerësimit që aplikohen edhe në vendet europiane , në përputhje me Manualin e Standarteve Europiane te Vlerësimit.

Disa të dhëna bazë për Shoqërinë « UJESJELLES MAT»sh.a. janë si më poshtë vijon:

Shoqëria « UJESJELLES MAT»sh.a është regjistruar në QKB me datë 16/07/1996 si Shoqëri Anonime.Aktualisht kapitali aksionar i regjistruar është **192.415.000** lekë, me aksioner të vetëm Bashkia Mat, me seli ne Burrel.

Aktiviteti i shoqërisë është me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatoreve dhe shitja e tij.Mirëmbajtja e sitemit të furnizimit të ujit të pijshëm,prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatoreve.Shërbimi i grumbullimit,largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura dhe shitja e tij,mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura,si dhe impianteve të pastrimit të tyre”

Nëe këtë datë të hartimit të këtij raporti,kur pasqyrat financiare të vitit 2016 janë të miratuara dhe dorëzuara në organet kopetente dhe të audituara nga Audituesit Ligjor,grupi i kapitaleve te veta, duke mos përfshire rezultatn financiar që do të rezultojë nga viti 2017,pasi Pasqyrat Financiare të këtij viti janë në proces hartimi apo mbyllje rezulton si më poshtë:

- Kapitali i regjistruar.....192.415.000 lekë
- Humbje e mbartur ..... - 71.931.633 lekë
- Fitimi i pashpërndarë.....546.486.lekë
  
- **TOTALI I KAPITALIT.....121.029.553 lekë**

**I.Zmadhimi i Kapitalit Aksionar të« UJESJELLES MAT»sh.a do të bëhet nga përfshirja në Aktive dhe në Kapitalin Aksionar të Shoqërisë « UJESJELLES MAT»sh.a e Objekteve,Ujësells sipas Njësive Administrative të Bashkisë Mat që janë vlerësuar nga Ekspertët e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme zj Vaide Gruda dhe z Sami Gjeta sipas Tabelës si më poshtë vijon:**

f.2



**Tabela përmbledhese e Ujësjetësive të Vlerësuar nga Ekspertët e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme,**  
sipas Vendimit nr 4 datë 01.10.2017.

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Viti</b>	<b>Kosto e ndërtimit</b>	<b>Amort.akum. derimë 31.12.2016</b>	<b>Dëmtimet</b>	<b>VLERËSUAR</b>
<b>I</b>	<b>NJADMIN.ULEZ</b>					
1	Ujësjetësi Ulez	1991	36282482	2902599	-	33379883
2	Kanal ujeravetëzeza Ulez	1990	26916019	2153282	-	24762737
<b>II</b>	<b>NJ ADMIN .MACUKULL</b>					
3	Uj. fshati Macukull	2011	68282300	4779761	-	63502539
4	Uj. Cuka-Gjucaj-Valxhi	2011	21045632	1473194	-	19572438
5	NdUjësjetësifsh Vig	2013	34490552	1835452	-	32655100
<b>III</b>	<b>NJ ADMIN .DERJAN</b>					
6	Ujësjetësi Lami Madh	1993	4857080	339996	-	4517084
7	Ujësjetësi Mësuç	2008	135000	14040	-	120960
<b>IV</b>	<b>NJ ADMIN KOMSI</b>					
8	Ujësjetësi Gërman	2010	50448621	15387290	-	35061331
9	Ujësjetësi Frankth	2009	66437280	9475616	1139880	55821784
10	Ujësjetësi Muzhakë	2014	46556609	13050091	-	33506518
<b>V</b>	<b>NJ ADMIN LIS</b>					
11	Ujësjetësi Shoshaj	2012	35442022	2679927	-	32762095
12	Ujësjetësi Mallunxë	2013	52267553	5226755	-	47040798
<b>VI</b>	<b>NJ ADMIN .BAZ</b>					
13	Ujësjetësi Karicë	2012	13059780	1361978	-	11697802
14	Ujësjetësi Baz	2011	157100237	14139021	-	142961216
	<b>TOTALI</b>		<b>613.321.167</b>	<b>74.819.002</b>	<b>1.139.880</b>	<b>537.362.285</b>

Pra sic rezulton nga Tabela e mësipërme Kapitali i Shoqërisë "UJESJELLESMAT" sh.a do të rritet në vlerën 537.362.285 (pesëqind e tridhjetë e shtatë milion e treqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë për 14 (katërbëdhjetë) Ujësjetësat e vlerësuar si më sipër.

f.3



Për efekt të rumbullakosjes së shifres së kapitalit, kapitali i regjistruar do të zmadhohet për **537,362,000** lekë, ku shuma për **285** lekë do të kalojë në zvogëlimin e Humbjes së mbartur.

Në kontabilitetin e shoqërisë ky veprim do të pasqyrohet si më poshtë :

- Shtesë (debi) e llog.(213 « aktiveve afat gjata mate.. » për.....537.362.285 lekë
- Shtesë (kredi) e llog.(101)«Kapitali Aksionar i regjistruar për .....537.362.000 lekë
- Shtesë (kredi) te llog.....(108) Humbje te mbartur për.....285 lekë

**Kapitali i regjistruar i shoqërisë do të zmadhohet per 537.362.000 lekë**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë « UJESJELLES MAT » sh.a Burrel para ketij misioni është **192.415.000** lekë, me **192.415** aksione me vlerë nominale **1.000** lekë për aksion.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, zmadhohet për **537.362.000** lekë. Efekti i ndryshimeve të kapitalit të regjistruar është si më poshtë vijon:

- Kapitali i regjistruar para zmadhimit ..... 192.415.000 lekë
- Shtesë e Kapitalit të regjistruar.....537.362.000 lekë
- Kapitali i regjistruar pas zmadhimit .....729.777.000 lekë
- Numëri i aksioneve para zmadhimit.....192.415 aksione
- Pakësim i aksioneve gjatë zmadhimit.....192.414 aksione
- Numëri i aksioneve pas zmadhimit.....1 aksion

**Kapitali I regjistruar i shoqërisë « UJESJELLES MAT»sh.a pas zmadhimit do të jetë 729.777.000 lekë (shtatëqintë e njëzetë e nëntë milion e shtatëqintë shtatëdhjetë e shtatë mijë), i cili përbëhet nga 1 aksion me vlerë 729.777.000 lekë aksioni.**

**Ky kapital,si para ashtu edhe pas këtij zmadhim kapitali,zotërohet 100% nga Bashkia Mat.**

Nga testet dhe verifikimet përkatëse që kam bërë rezulton se vlerat përkatëse të kapitalit të regjistruar,humbjes së mbartur dhe fitimit të pashpërndarë të Shoqërisë « UJESJELLES MAT»sh.a Burrel,është evidentuar saktësisht dhe i paraqitur në mënyrë korrekte në llogarië përkatëse të Bilancit Kontabël të ushtrimit 2016.

f.4



Për vlerësimin për rritjen e kapitalit jam mbështetur në Raportin “Mbi vlerësimin e Ujësellsava të Njësi Administrative Mat” të datës 18.12.2017 të Ekspërteve Vlerësues të Pasurive të Paluajtshme zj. **Vahide Gruda** dhe z **Sami Gjeta**, në Bilancin Kontabël të Ushtrimit 2016, si dhe në dokumenta të tjera të vëna në dispozicion nga ana e shoqërisë siç janë :Inventarët e pasurisë, analizat e llogarive ...etj.

Në përfundim të misionit që na është caktuar, duke kryer të gjitha ekzaminimet e nevojshme, pasi verifikuam të gjitha procedurat për zmadhimin e e kapitalit raportojme se e kemi plotësuar këtë detyre sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Sipas opinionit tonë, në procesin e këtij zmadhim kapitali të « UJESJELLES MAT » sh.a Burrel janë zbatuar të gjitha kërkesat e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar) kërkesa që përcaktohen në, Nenin 112, pika 1 dhe 2, nenin 145, pika 1, Nenin 168, pika 1, dhe Nenin 169, pika dhe 2 të këtij Ligji, si dhe të Ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar)

Ky raport mbahet në 4 (katër) kopje të njejta, ku një kopje mbahet në dosjen e punës të Audituesit Ligjor dhe 3 (tre) kopje dorëzohen në Asamblenë Shoqërisë.

**Audituesi Ligjor**

**Bujar RAMI**

Tiranë më 22.02.2017

